Udhëzime për DS-160
Formular për aplikim për vizë për SHBA

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Shkup, Maqedoni

January 2010

Informata bazë

- Formulari i ri online për aplikim për vizë jo-emigruese, DS-160 i zëvendëson këta formularë:

– DS-156 “Aplikacion për vizë jo-emigruese”

– DS-157 “Aplikacion shtesë për vizë jo-emigruese”

– DS-158 “Kontakt informata dhe histori për përvojë pune të parashtruesit të kërkesës për vizë jo-emigruese”

Përparësitë e parashtruesve të kërkesave

- Në vend se tre – një formular
- E tëra online – asgjë nuk duhet të plotësohet me dorëshkrim
- Mundësi për kërkesë familjare dhe grupore – nuk ka nevojë për plotësim të të dhënave të njëjta më tepër se një herë
- Mundësi për të ruajtur dokumentin – nuk ka nevojë që formulari të plotësohet i tëri menjëherë
- Parashtruesit e shpeshtë të kërkesave për vizë mund ta ruajnë aplikacionin dhe ta shfrytëzojnë përsëri sipas nevojës
- Shtypet vetëm faqja konfirmuese

Procesi i aplikimt

Bëni pagesën
- Në Bankën Komerciale
- Në Raiffeisen Bank

Caktoni terminin
- Nëpërmjet Shërbimit informativ për viza

Plotësoni formularin
- Online në https://ceac.state.gov/genniv/

Intervista
- Në Ambasadë
- Marrja e shenjave të gishtave

Marrja e vizës
- Një ditë pune pas bisedës

Vetëm formulari për aplikim ka pësuar ndryshime – Pjesët tjera të procesit mbeten të njëjta

Plotësimi i DS-160

Hapi 1 – Qasja në formular

- Shkoni në https://ceac.state.gov/genniv
- Lexoni udhëzimet dhe klikoni "Start Application"

Plotësimi i DS-160

Hapi 2 – Zgjedhni ambasadën

- Zgjedhni ambasadën ose konsullatën ku do të aplikoni
- Klikoni "Test Photo" për të filluar ngarkimin e fotografisë së juaj

Plotësimi i DS-160

Hapi 3 – Ngarkimi i fotografisë

- Zgjidhni lokacionin dhe fotografinë tuaj dhe klikoni "Upload Selected Photo"(Ngarkoni fotografinë tuaj)
- Nëse fotografia juaj i plotëson standardet kualitative klikoni "Continue Using This Photo" (Vazhdoni duke përdorur këtë fotografi)
- Nëse fotografia nuk kalon, klikoni "Continue Without A Photo" (Vazhdoni pa fotografi)



Plotësimi i DS-160

Hapi 4 – Plotësoni formularin

- Përgjigjuni në të gjitha pyetjet me kujdes dhe saktësi
- Dhënia e informatave të gabuara ose mospërgjigja në pyetjet e domosdoshme vetëm do të vonojë aplikimin tuaj



Plotësimi i DS-160

Ruajtja e aplikacionit

- Nëse nuk mund të përfundoni plotësimin menjëherë, atëherë mund ta ruani aplikacionin në kompjuterin tuaj për të vazhduar më vonë
- Klikoni "Save" në pjesën e poshtme të çdo faqeje për regjistrim të të dhënave për të ruajtur aplikacionin
- Klikoni “Save Application to File” (Ruani aplikacionin në kompjuter)
- Klikoni “Save” dhe zgjidhni vendin ku dëshironi të ruani aplikacionin tuaj
- Nëse brenda 20 minutave nuk ka aktivitet, koha e seancës tuaj do të kalojë dhe ju do të duhet të filloni procesin nga e para, andaj mos harroni që shpesh të klikoni “Save”.

Plotësimi i DS-160

Gjetja dhe përdorimi i aplikacionit të ruajtur

- Gjeni dhe zgjidhni aplikacionin e ruajtur
- Klikoni “Upload Data” (Ngarkoni të dhënat)

Plotësimi i DS-160

Informata shtesë

- Në qoftë se një pyetje nuk ka të bëjë me ju, ju duhet të zgjedhni “Does Not Apply” (Nuk më përket)
- Jepni përgjigje të plota dhe përfshini sa më shumë detaje që mundeni
- Kushtoni vëmendje të veçantë pyetjeve me po/jo përgjigje që gjenden në pjesën e fundit – shtrembërimi i fakteve mund të rezultojë me ndalesë të përhershme për marrje të vizës





Plotësimi i DS-160

Hapi 5 – Kontrolloni aplikacionin tuaj

- Ju keni mundësinë për të kontrolluar dhe ndryshuar përgjigjet tuaja para se të parashtroni kërkesën tuaj
- Kontrolloni me kujdes nëse çdo gjë është e saktë – më vonë do të jetë e pamundur të bëni ndryshime

Plotësimi i DS-160

Hapi 6 – Parashtrimi i aplikacionit tuaj

- Pasi ta keni parashtruar aplikacionin tuaj, ju nuk mund të bëni ndryshime në të
- Kliku në "**Sign and Submit Application**" (Nënshkruaj dhe parashtro aplikacionin) në fakt paraqet nënshkrim elektronik me të cilin vërtetoni se të gjitha përgjigjet në aplikacion janë të vërteta



Plotësimi i DS-160

Hapi 7 – Shtypja e faqes tuaj konfirmuese

- Shtypni faqen konfirmuese
- Në intevistë duhet të sillet vetëm fleta e shtypur konfirmuese
- Nëse dëshironi, ju mund ta shtypni tërë aplikacionin për dosjen tuaj personale
- Faqja konfirmuese mund t'i dërgohet dikujt tjetër nëpërmjet e-mail-it (p.sh, nëse e plotësoni formularin për dikë tjetër)



Plotësimi i DS-160

Hapi 7 – Shtypja e faqes tuaj konfirmuese (vazhdim)

- Kështu duket faqja konfirmuese nëse nuk keni ngarkuar fotografi
- Në atë rast, ju do të duhet të sillni një fotografi me vete në ditën e intervistës



Vërejtje

Formulari DS-160 i zëvendëson vetëm formularët për aplikim. Dokumentet tjera mbeten edhe më tej të domosdoshme

- Studentë: I-20
- Shkëmbim i vizitorëve: DS-2019
- Diplomatët dhe zyrtarët: Notë diplomatike

Dhe, shumica e parashtruesve të kërkesës për vizë edhe më tej duhet të prezantojnë dëshmi për lidhje të ngushta me vendbanimin e tyre